



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA - PRESIDENT'S OFFICE

Në bazë të nenit 59 paragrafi 1 të Ligjit të Prokurimit Publik nr. 05/L -068 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 1 dt. 06 janar 2016) për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237) dhe pikës 40.1 të Rregullorës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik 16.04.2018, ZKA në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarin përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë :

V E N D I M
PËR EMRIMIN E KOMISIONIT PËR VLERSIMIN E OFERTAVE

“Furnizim me Farë Gruri”

GL 651 22 074 121

Anëtarët e komisionit sipas këtij vendimi janë:

1. Ejup Byqmeti kryetar i komisionit
2. Ardian Ibishi anëtar i komisionit
3. Nazif Kqiku anëtar i komisionit

Neni 2

Autoriteti kontraktues në bashkëpunim me Zyren e Prokurimit duhet të caktoj një komision për vlerësimin e tenderëve me funksione vetëm këshilluese për zyrtarin përgjegjës e prokurimit.

Neni 2.1

Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen plotësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete afariste.

Neni 2.2

Komisioni do të funksionojë nga dita e miratimit të vendimit lidhur me themelimin e tij deri në plotësimin e të gjitha detyrave të dhëna nga autoriteti kontraktues me shkrim, ose derisa të mund të merret vendimi për ndërprerjen e procedurës së prokurimit.

Neni 2.3

Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të ftojë, vetë ose me iniciativën e komisionit, ekspertë të jashtëm atëherë kur kërkohen njohuri teknike ose të specializuara për lëndën e prokurimit dhe që përndryshe nuk gjenden brenda autoritetit kontraktues. Ekspertët e tillë duhet të pranojnë me shkrim që në mënyrë të prerë i nënshtrohen dispozitave të nenit 11 të LPP në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete afariste.

Neni 2.4

Në përfundim të detyrës së tij, Komisioni do t'i japë zyrtarit përgjegjës të prokurimit një rekomandim bashkë me një raport për punën e tij dhe një deklaratë me arsyet që e mbështesin atë rekomandim.

Neni 3

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të fillojë punën menjëherë ne rastin e pranimit të këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi është i plotfuqishëm me aktin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe zyrtarit përgjegjës të Prokurimit.

Shqipe Hoxha

Zyrtare Përgjegjëse e Prokurimit



Alban Hyseni

Kryetari i Komunës